

■ Galeria Kombëtare e Arteve përfundon procesin e mbledhjes së veprave të artit të shpërndara që nga 1981

Zhduken 96 vepra arti, Galeria e Arteve rikthen vetëm 66 objekte të shpërndara

Julia VRAPI

Nga 162 vepra të autorëve shqiptarë pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve vetëm 66 prej tyre janë mundur të rikthehen. Në fillim të vitit 2014 Galeria Kombëtare e ktheu në prioritet kthimin e këtyre veprave të shpërndara ndër vite. Pranë galerisë bëjnë me dije se gjatë kësaj kohe është zhvilluar një proces jo i lehtë dhe në fund janë kthyer 66 piktura dhe skulptura. Një pjesë të këtyre vepra GKA i ka ekspozuar për publikun, pasi kanë kaluar më herët përmes procesit të restaurimit. Veprat, që mungojnë i takojnë autorëve të njohur shqiptarë si Vangjush Mio, Odhise Paskali, etj. Veprat e shpërndara nga fondi i GKA shtrihen në një hark kohor nga viti 1981 deri nga 2005. Por ajo që është më e rëndësishme për 96 veprat tashmë po merret Prokuroria. “Të gjithë këto vepra, që mungojnë janë në proces hetimi dhe po merret Prokuroria. Puna për kthimin e veprave, që janë marrë nga fondi i GKA dhe janë shpërndarë nëpër institucione të ndryshme dhe jo vetëm në Tiranë ka nisur vite më parë. Në 2014 nisi një punë dhe më intensive për të ardhur deri në fund të këtij procesi, ku nga 162 vepra arti vetëm 66 u bë e mundur të kthehen. Për ato që mungojnë GKA është bërë denoncimi dhe janë organet ligjore që po e ndjekin” bëjnë me dije pranë GKA. Një pjesë e mirë e 96 veprave që nuk janë kthyer sipas GKA kanë qenë të shpërndara në institucione, që kanë ekzistuar deri në vitin 1990, por një pjesë tjetër ekzistojnë dhe sot. “Për 96 veprat e artit në pikturë dhe skulpturë dosja është në prokurori për hetim. Kanë qenë të shpërndara jo vetëm në Tiranë, por dhe në institucione të tjera jashtë kryeqytetit. Veprat kanë qenë në institucione si Ish Komiteti i Marrëdhënieve me Botën e Jashtme, ish Komiteti i Veteranëve të Luftës, Uzina e Autotraktorëve “Enver Hoxha”, ish Komiteti i Rrethit, ish shtëpia botuese “Naim Frashëri”, etj. Por dhe Shtëpia e Kulturës në Gramsh ka pasur një vepër, 7 vepra të tjera kanë qenë në ish Shtëpinë e Kulturës në Shkodër. Vepra të pakthyer ka dhe Ministria e Jashtme apo Ministria e Arsimit, etj”, pohojnë pranë GKA.



Për 96 veprat e artit në pikturë dhe skulpturë dosja është në prokurori për hetim. Kanë qenë të shpërndara jo vetëm në Tiranë, por dhe në institucione të tjera jashtë kryeqytetit. Veprat kanë qenë në institucione si Ish Komiteti i Marrëdhënieve me Botën e Jashtme, ish Komiteti i Veteranëve të Luftës...

Restaurimi i veprave

Pothuajse të gjitha veprat që u kthyen në GKA kishin nevojë emergjente për restaurim, prandaj ato u nënshtuan menjëherë ndërhyrjeve konservuese nga laboratorit të restaurimit dhe përbushjes së standarteve për ekspozimin e tyre. Ekspozita me veprat e kthyer do të qëndrojë e çelur në 28 gusht, ku janë të ekspozuara 45 piktura dhe 9 skulptura. Veprat kanë qenë fondin e Galerisë Kombëtare të Arteve dhe që nga viti 1981 kanë nisur të merren gradualisht nga institucionet kryesore të vendit për dekorimin e ambienteve të tyre. “Me qëllim ekspozimin dhe kurimin e imazhit, këto vlera jetuan për shumë vite, (disa prej tyre nga viti 1981) në disa institucione të shtetit shqiptar. Dokumentacioni përkatës dhe afatet kohore nuk u respektuan, prandaj shumë prej

këtyre veprave u braktisën për vite me radhë nëpër magazina, u dëmtuan dhe u lanë jashtë çdo standarti të ruajtjes dhe mirëmbajtjes, ndërsa shumë të tjera u zhdukën”, deklaronte disa ditë më parë GKA gjatë hapjes së ekspozitës. Këto vepra janë punë të mbi artistëve shqiptar si Vangjush Mio, Abdurrahim Buza, Zef Kolombi, Sadik Kaceli, Angelin Dodmasej, Zef Shoshi, Guri Madhi, Danish Jukni, Odise Paskali, Agim Zajmi, Qamil Grezda, Sali Shijaku, Ismail Lulani, Kel Kodheli, Skënder Kamberi, Petro Kokusha, Hasan Nallbani, Agim Faja, Bashkim Ahmeti, Mustafa Arapi, Besim Golemi, Nikolin Ivanaj, etj. Sipas galerisë ekspozita nuk bazohet në një koncept kuratorial, por vlera e tyre artistike kombëtare, kthimi në fondin e GKA, meritojnë të shfaqen për të gjithë ata që e duan artin figurativ shqiptar.

Shqipëria në komunizëm, deri më 30 gusht fotot në Muzeun Kombëtar

Ekspozita fotografike “The Other Side of Albanian Communism” (Ana Tjetër e Komunizmit shqiptar) është një ekspozitë që mundohet ta shikojë në mënyrë integrale historinë e zhvillimit të sundimit komunist në jetën publike të Evropës Lindore. Për herë të parë për publikun janë publikuar në Muzeun Historik Kombëtar foto sesi dukej Shqipëria e viteve të fundit të diktaturës në sytë e një fotoreporteri të huaj. Ekspozita do të qëndrojë për publikun deri më datë 30 gusht. Ekspozita në vetvete është një thirrje për një dialog të hapur me të shkuarën dhe dëshmi antropologjike e vizuale e së shkuarës për atë çka ishte Shqipëria në fund të viteve '80. Kjo ekspozitë ka bërë bashkë fotografët e famshëm hollandezë, të cilët kanë dokumentuar të gjithë periudhën para dhe gjatë revolucioneve të ndryshme në vendet e ish Bllokut Lindor. Ata kanë qenë dëshmitarë të momenteve historike, të tilla si krijimi në vitin 1980 i bashkimit polak të tregtisë, Solidariteti, në Gdansk; rënia e Murit të Berlinit dhe Revolucioni në Rumani, në vitin 1989. Gjithsesi, ata kanë kapur edhe momentet e zakonshme të përditshmërisë. Tërësia e fotove paraqet një pamje të paparashikuar dhe shumëplanëshe të Bllokut Lindor të asaj kohe. Fotografitë analoge bardh e zi, por edhe me ngjyra, mbajnë firmën e fotografit, duke regjistruar mënyrën se si ai ose ajo kanë fotografuar në ato kohë. Kjo ekspozitë bashkon rëndësisë historike të ngjarjeve sipas këndvështrimit të gjerë të foto-gazetarisë hollandeze në vitet 1980 dhe 1990. Të gjithë fotografët pjesëmarrës në ekspozitë janë një shtyllë e fortë mbështetëse për një brez të ri të fotografëve të dokumentarëve dhe të gazetarisë. Një pjesë e veçantë e ekspozitës i dedikohet punës së foto-gazetarit Piet den Blanken, i cili ka udhëtuar nëpër Shqipëri në vitin 1986, si pjesë e grupit të “shokëve të idealit”. Pavarësisht, ligjit që ndalonte kontaktet midis shqiptarëve dhe vizitorëve të huaj, si edhe ligjit që ndalonte realizimin e fotografive në rrugë, ai ia doli të bënte shumë fotografi të shqiptarëve dhe jetës së tyre të përditshme nën regjimin komunist. Me hapjen e saj ekspozita ka pasur jo pak vëmendje në MHK nga vizitorët këto ditë të muajit gusht, të cilët kanë dhe disa ditë mundësi për të parë fotot.



Vepra me imazhin e Donald Trump në qytetin e Prizrenit

■ Një lider si Donald Trump, nëse deri sot nuk ka shërbyer për asgjë, së paku për një numër artistësh është inspirim për krijim veprash arti. Fytyra e tij krenare është vendosur në Prizren, në qendër të qytetit. Siç thotë koncepti artistik i veprës, vepra është vendosur në qytetin e bukur të Prizrenit, ku puthen tri ideologjitë: modernizmi, minarja që u shkatërrua në vitin 1963 me pretekstin se po e dëmtonte modernizimin e Prizrenit dhe të gjeturat arkeologjike të periudhës romake. “Think Big” është fo-

tografi e grupit artistik OPA- Obsessive Possessive Aggression, e cila është pjesë e bienales Autotrada Biennale, e cila ka nisur para disa ditësh në Prizren. OPA përbëhet nga Slobodanka Stevceska dhe Denis Saraginovski, dy artistë që kanë studiuar në Shkup dhe punojnë së bashku në inspirimin e tyre artistik. Monumenti i ri në Prizren, me fytyrën e Trump gjendet saktësisht në vendin ku kanë ekzistuar portrete të bronzit që përkujtonin heronjtë e Luftës së Dytë Botërore. Të gjitha ato janë zhdukur.

Muzeu i Gjetheve, për 3 muaj mbi 4 mijë vizitorë

■ Një numër prej 4400 vizitorësh kanë qenë deri tani në Muzeun e Gjetheve. Drejtoresha Etleva Demollari pohon se muzeu nuk do mbetet thjesht në kuadrin e vizitës or nga shtatori vizitorët do të mund të dëgjojnë dëshmitë e jherëzve që vuajtën regjimin. “Do mundohemi që muzeun ta kthejmë dhe në një qendër debati, kryesisht në brezin e ri. Ne duam, madje kemi dhe një projekt për ti afruar personat, të cilët kanë vuajtur gjatë periudhës komuniste, personat e perëkutuar që mund të kthehen në tuda të muzeut” pohoi drejtoresha

Etleva Demollari. Në 3 muaj mbi 4 mijë vizitorë vendas dhe të huaj kanë parë nga afër artifaktet. Drejtoresha e Muzeut Etleva Demollari thotë se ka nisur edhe çelja e debatit mbi periudhën e diktaturës përmes personaliteteve, që e kanë vuajtur regjimin. “Dokumentet që janë pasqyruar në muze janë përdorur vetëm pseudonimet, nuk janë treguar emrat e vërtetë. Arsyja është se ky është një muze dhe ne duam të tregojmë fenomenin se çfarë ka ndodhur. Ndoshta një ditë edhe ne do ti tregojmë këto emra”, tha ajo.

Ministrja kosovare e Kulturës pret në takim artistët

■ Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi zhvilloi një takim me një grup të artisteve, të fushave të ndryshme të artit, ndër to Zake Prelvukaj, Burbuqe Berisha, Arbnesha Grabovci-Nixha. Ministria Dumoshi diskutoi me artistet për gjendjen e artit në Kosovë. Ndër tjera, artistet e uruan ministrin Dumoshi për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar mbarëvajtje dhe suksese. Disa ditë më parë ministrja Dumoshi vizitoi edhe ekspozitën e Festivalit Ndërko-

mbëtar të Animacionit “Anibar” në Galerinë e Arteve në Pejë. Ministria Dumoshi u shpreh e kënaqur me entuziazmin e të rinjve kreativ dhe tha se MKRS-ja është e përkushtuar që të ndihmojë jetën kulturore të Kosovës, duke krijuar kushte më të mira dhe duke e subvencionuar atë. Ndërsa drejtori i Festivalit, Vullnet Sanaja e falënderoi ministrin për vizitën dhe për gatishmërinë për të bashkëpunuar edhe në të ardhmen. Ky festival edhe këtë edicion ka bërë bashkë artistë të huaj dhe shqiptarë.